REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA CËRRIK**

Nr._____Prot. Cërrik, më 20.01.2020

**Shtojca 16**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data 20.01.2020]
Për: *[***"VIANTE KONSTUKSION" sh.p.k,Gramsh** *]*
Procedura e prokurimit: *Kerkese per propozim*
Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-44362-11-21-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës" ***Ndertim zyrash me nje ndalese Nj.A. Klos, Bashkia Cerrik***", është vënë në dispozicion fondi prej ***6249903*** *( gjashte milion e dyqind e dyzete e nentemije e nenteqind e tre ) leke pa TVSh* vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Cërrik, per vitin 2019, me financim 3 vjecar,

| Nr. | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 |
|---|---|---|---|
| 1 | 20% | 40% | 40% |

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[25.11.2019] [47]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme
Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik **"ELDA-VL"** sh.p.k *me* Nr.**Nipt K67106202** nuk ka paraqitur oferte.
2. Operatori Ekonomik "**COLOMBO SH.P.K** me Nr.**Nipt J82916489E** me oferte me vlere,**5031037** (*pese milion e tridhjete e nje mije e tridhjete e shtate*) leke pa tvsh.
3. Operatori Ekonomik "**Viante" SH.P.K** me Nr.**Nipt K47103804L** me oferte me vlere,**6199903** (*gjashte milion e njeqind e nentedhjete e nente mije e nenteqind e tre*) leke pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. *Operatori Ekonomik* **" ELDA-VL"** ***sh.p.k***
2. *Operatori Ekonomik* **" COLOMBO SH.P.K"**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik **"ELDA-VL"** sh.p.k *me* Nr.**Nipt K67106202** nuk ka paraqitur oferte.

**Komisioni i Vleresimit te ofertave vendosi te skuaklifikoje Operatorin ekonomik "ELDA-VL" pasi nuk ka paraqitur oferte dhe dokumentacionin e nevojshem administrative –ligjor- kualifikues te kerkuar.**

2. Operatori Ekonomik "**COLOMBO SH.P.K** me Nr.**Nipt J82916489E** me oferte me vlere **5031037** (*pese milion e tridhjete e nje mije e tridhjete e shtate*) leke pa tvsh.

**Nuk ploteson kriteret per kualifikim**:

1. Operatori ekonomik ofertues ka nderhyre ne preventivin e paraqitur nga AK duke ndryshuar 3 zera ne pershkrimin e punimeve ne kundershtim me:

**Seksioni 1 Hartimi i ofertës**

1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e

përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

Nenin 51 te LPP pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën, në përputhje me pikën 1 të nenit 53 të këtij ligji.

2.Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën."

E pikerisht zerat e meposhtem:

Jane:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13 | 2.166 | F.V.hekur betoni I vjaskuar Ø<12mm(ketu perfshihet edhe zgara Φ8 mm 15X15cm) | kg | 2600 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 18 | 2.86 | Mur tulle me bira t=12cm ne ndertse&tarace | m3 | 5 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 14 | 481/3 | FV Percjelles Cu, k.z., fleksibel, 4 $mm^2$ | ml | 100 |

Jane ndryshuar:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13 | 2.166 | F.V.hekur betoni I vjaskuar Ø<12mm(ketu perfshihet edhe zgara Φ mm 15X15cm) | kg | 2600 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 18 | 2.86 | Mur tulle me bira t=25cm(tulla mbajtese m>75kg/cm2) | m3 | 5 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 14 | 481/3 | FV Percjelles Cu, k.z., fleksibel, 4 $mm^3$ | ml | 100 |

2. Në pikën Kerkesat per kualifikim AK ka kërkuar nga ofertuesit: *g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Në përmbushje të këtij kriteri,shoqeria Colombo" Shpk ka paraqitur vërtetimin e debisë Nr.2549 Prot, datë 14.11.2019 të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e OSHEE Fier, sipas të cilave ,shoqëria në fjalë rezulton të ketë në total 0 (zero) lekë detyrime për faturat e energjisë,për kontratat (me kod) FI1A170043014295 ndërkohë, sipas ekstraktit të QKB të paraqitur nga shoqëria Colombo" Shpk,rezulton se kjo shoqëri ka adresë të ushtrimit të aktivitetit edhe në Elbasan por nuk ka paraqitur informacion për shlyerjen e detyrimeve të energjisë për kontratën që i përket adresës ne fjalë. Në nenin 26, pika 7, gërma "c" të VKM parashikohet se :"*Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon një vërtetim qëkonfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonëse 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik".*

Në respektim të dispozitës së sipërcituar, operatorët ekonomik duhet të provojnë me dokumentacion shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për të gjitha kontratat e secilës adresë ku ushtrojnë aktivitet. Në kushtet kur, sipas ekstraktit të QKB të paraqitur në sistemin e prokurimit eletronik, shoqëria "Colombo" Shpk ka adresë të ushtrimit të aktivitetit edhe në Elbasan, kjo shoqëri duhet të kishte paraqitur informacion për shlyerjen e detyrimeve të energjisë për kontratën që I përket adresës në fjalë, gjë që nuk rezulton të jetë bërë.

Sa më sipër, shoqëria "Colombo" Shpk nuk ka paraqitur informacion mbi shlyerjen e detyrimeve të

energjisë për kontratat përkatëse, për secilën adresë ku ushtron aktivitet.

3. Ne kerkesat per kualifikim eshte kerkuar: *1. Pune te ngjashme: a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogla se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë te tre viteve te fundit nga data e hapjes se ofertave. b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë te tre viteve te fundit nga data e hapjes se ofertave, është jo më e vogel se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Ne rastin konkret konsiderohen punime te ngjashme ato objekte qe jane te kategorise: **N.P.–2A** *Ndertime civile dhe industrial* per shkak qe behet fjale per ndertimin e nje objekti te ri: Ndertim zyrash me nje ndalese Nj.A. Klos, Bashkia Cerrik.
Operatori ekonomik ka paraqitur per te provuar kerkesen e mesiperme objektin: Rikonstruksion I poliklinikes se specialiteteve duke mos plotesuar keshtu kushtin per punime te ngjashme duke qene se ne vijim te emertimit dhe te verifikimit te situacionit keto punime i perkasin kategorise: **N.P.–3A** Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industrial, veshje fasada.
Sa me siper Colombo sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion per te plotesuar kriterin e mesiperm.

4. AK ka kerkuar *një punësim mesatar i të paktën **40 (dyzete)** personave, për periudhën **Maj-Tetor 2019** të vërtetuar me; Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Maj-Tetor 2019.** List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen **Maj-Tetor 2019** shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.*

Per te vertetuar kerkesen e mesiperme operatori ekonomik Colombo sh.p.k. ka paraqitur liste pagesat e punonjesve sipas formatit te legjislacionit shqiptar ku konstatohet se ne asnje muaj ky operator ekonomik nuk permbush numrin 40 (dyzete) persona me nje punesim me kohe te plote. Konstatohet se ne pergjithesi nuk i kalojne 25 punonjes per cdo muaj.
Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin 8 e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"*
Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*
Persa me lart mos permbushja e kriterit te mesiperm percakton se punonjesit e kualifikuar dhe te tjere punonjes nuk jane te angazhuar me kohe te plote per numrin minimal te kerkuar ne kerkesat per kualifikim.

5. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje lloj dokumentacioni per punonjesit e kualifikuar si me poshte:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Teknik ndertimi | -kontratën individuale të punës;<br>-një dokument (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), që të vërtetojë kualifikimin profesional perkates),<br>-certifikatat e sigurimit teknik IQT ose ekuivalente |
| 1 | Elektricist | -kontratën individuale të punës;<br>-një dokument (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), që të vërtetojë kualifikimin profesional perkates),<br>-certifikatat e sigurimit teknik IQT ose ekuivalente |
| 3 | Karpentjer | -kontratën individuale të punës;<br>-një dokument (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), që të |

| | | |
|---|---|---|
| | | vërtetojë kualifikimin profesional perkates),<br>-certifikatat e sigurimit teknik IQT ose ekuivalente |
| 3 | Punonjes lartesie | -kontratën individuale të punës;<br>-një dokument (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), që të vërtetojë kualifikimin profesional perkates),<br>-certifikatat e sigurimit teknik IQT ose ekuivalente |

6. Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion per 30 punonjes te kualifikuar gjithsej ne listepagesen e muajit te fundit sipas kerkesave per kualifikim konstatohet se vetem 2 prej tyre jane te punesuar me kohe te plote.

   Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*"

   Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*"

   Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

   *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

   *a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*

   *b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*

   *c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*

AK ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me dokumentacion provues se disponojnë në stafin e tyre punonjës me profesion saldator, shofer, karpentier, staf inxhinierik, elektricist etj. Në kriterin e vecantë të kualifikimit kapaciteti teknik kërkohet shprehimisht se stafi teknik I shoqërisë te jene te perfshirë në listepagesa. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar rezultojne 28 punonjes te kualifikuar me kohe te pjesshme. Kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

7. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mjetet e paisjet e meposhtme ne kundershtim me kerkesat per kualifikim:

| Nr | Emri i mjetit | Njesi | sasi | statusi |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Kamion vinxh vetëshkarkues 6-8 ton | cope | 1 | Pronësi ose me qera |
| 6 | Mjet germimi me goma | cope | 1 | Pronësi ose me qera |

8. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat per mallrat e kerkuara ne kerkesat per kualifikim:

13.Deri diten e tenderit operatoret duhet te paraqesin mostrat per mallrat pjese e kontrates se meposhtme:

1. Llampe sinjali 220V
2. Celes ndricimi 250V 10A
3. 1 kg boje hidro plastike
4. Saracineka PPR 3/4

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[”**Viante konstruksion**“* ***sh.p.k,Gramsh***] *me* ***Nr.Nipt*** **K47103804L** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [**6199903 (***gjashte milion e njeqind e nentedhjete e nente mije e nenteqind e tre)* leke pa tvsh]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkise Cerrik, *Lagja Nr.2 Ruga “Gjimnazistet 1962*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.
Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar _____, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [__________], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17.12.2019
Ankesa: po
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 27.12.2019

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**
**K R Y E T A R I**

**Andis SALLA**